

JICA në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK)

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta shtrihet në bregdetin e Adriatikut me një territor prej 22,230 ha, rreth 100 km larg nga Tirana. Është një ekosistem kompleks ku ndërthuren disa habitate me një larmishmëri llojesh të florës dhe faunës së egër, endemike, subendemike, të rralla, të kërcënuara e të rrezikuara për zhdukje. Në këtë zonë ndodhet vendfolezimi i vetëm në Shqipëri i Pelikanit kaçurrel i përfshirë në listën e kuqe të IUCN (NT). Zona e parkut është shpallur në vitin 1995 si zonë me rëndësi ndërkombëtare për shpendët e egër ujorë [Zonë Ramsar].



Projekti i Bashkëpunimit Teknik JICA në PKDK nisi në muajin Maj të vitit 2021 për një periudhë tre vjeçare nën Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM). Projekti synon të krijojë një model të ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura (ZM) në Shqipëri përmes menaxhimit të bazuar në ekosistem duke u mbështetur në përvoja të fituara nga zbatimi i projektit.

Për më shumë detaje, vizitoni uebin e JICA: www.jica.go.jp
Gjithashtu, për më shumë detaje për Parkun Kombëtar vizitoni uebin e AKZM: akzm.gov.al



Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve për Përmirësimin e Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta

Administrata e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta
Adresa: Zyrat e Parkut 9022 Divjakë, Lushnjë
Tel: (+355) 69 890 0540
Email: dknpmedia@hotmail.com



PROJEKTI I BASHKËPUNIMIT TEKNIK JICA
“PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR
PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TË BAZUAR
NË EKOSISTEM NË PARKUN KOMBËTAR
DIVJAKË-KARAVASTA”

Menaxhimi i Bazuar në Ekosistem për të nxitur ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura.

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK) është një vend unik që përfshin një gamë të larmishme peizazhesh, duke përfshirë ekosistemet lagunore, pyjore, grykëderdhjet e lumenjve, zonat detare dhe bregdetare, zonën kodrinore, dhe zonat e prodhimit bujqësor dhe ato urbane.

Menaxhimi i Bazuar në Ekosistem (MBE) qëndron në kompromisin midis përdorimit të burimeve natyrore nga njëra anë, dhe mbrojtjes e ruajtjes së biodiversitetit e shërbimeve që ofron nga ana tjetër.



MBE është një qasje e integruar e menaxhimit që njeh të gjitha ndërveprimet brenda sistemit duke përfshirë këtu ndërveprimin njerëzor krahas problemeve të veçanta si ruajtja e llojeve ose shërbimet e ekosistemit.


Metodologjia e Projektit për Menaxhimin e Ekosistemit

1 JICA PKDK DHE OBJEKTIVAT E SAJ

Projekti i bashkëpunimit teknik JICA në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK) është një lloj task-force e përbashkët midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), për të promovuar përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të parkut kombëtar, duke shfrytëzuar burimet në dispozicion brenda parkut dhe zonës përreth sipas menaxhimit të bazuar në ekosistem.

Qëllimi i projektit është të realizojë qasjen gjithë përfshirëse për të realizuar ekuilibrin e duhur të mbrojtjes dhe prodhimit bazuar në planin e menaxhimit të parkut përmes iniciativës aktive të ndërmarrë nga Komiteti i Menaxhimit të Parkut.

Objektivat e Projektit JICA PKDK



Qeveria Shqiptare ka përcaktuar kuadrin ligjor për Komitetin e Menaxhimit të Parkut dhe Planin e Menaxhimit të parkut. Projekti synon që aktivitetet dhe rezultatet në PKDK mund të shërbejnë si një model për t'u aplikuar në parqet e tjera kombëtare në Shqipëri.

2 PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT JICA PKDK

Të gjithë aktorët marrin një rol në menaxhim përmes Komitetit të Menaxhimit (KM)


Sipas Ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" neni 41, ka disa akte nënligjore që rregullojnë komitetin, anëtarët dhe përgjegjësitë e tij, si për shembull: VKM Nr. 593 datë 19.10.2018 pika 2 dhe 4, "Për përbërjen, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore" si dhe akte të tjera nënligjore.

Grupet Teknike të Punës mbështesin KM për të shqyrtuar masat e mundshme për zgjidhjen e çështjeve specifike.

Projekti bashkëpunon me grupet tematike të punës të drejtuara nga AdZM

- 1) Për ruajtjen e biodiversitetit
- 2) Për bujqësinë e qëndrueshme
- 3) Për peshkimin e qëndrueshëm
- 4) Për edukimin mjedisor & eko-turizmin

Cikli PDCA: Planifikimi, Zbatimi, Kontrolli dhe Veprimi. KM me AdZM e trajtojnë këtë cikël çdo gjashtë muaj.



Zyra e PKDK (AdZM) si sekretariat i KM koordinon burimet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të caktuara (Fig. 2)



- Kryen një vlerësim për të kuptuar statusin aktual të temave të veçanta të parkut dhe gjetjen e mënyrave për ti zgjidhur ato.

- Përzgjedh disa çështje urgjente që duhen trajtuar duke patur parasysh realizueshmërinë dhe përparësinë.

- Zbaton aktivitete për përmirësimin e cilësisë përmes koordinimit dhe bashkëpunimit me agjensitë përgjegjëse dhe grupet e interesit.

- Kryen një vlerësim mbi progresin dhe rezultatet.

- Vijon punën në çështjet e tjera dhe përzgjedh të tjera që do të trajtohen për përmirësim të mëtejshëm

Metodologjia e Projektit për Menaxhimin e Ekosistemit

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM:

Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i Zonave të Mbrojtura (ZM) nëpërmjet Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem (MBE) të jetë i konsoliduar në Shqipëri.



QËLLIMI I PROJEKTIT:

Zhvillimi i një modeli mbi menaxhimin e bazuar në ekosistem të ZM sipas përvojave të PKDK.

Rezultatet:

- 1) **Funksionim më i mirë i Komitetit të Menaxhimit (KM)** Projekti mbështet krijimin e Grupeve tematike të Punës (GP) në kuadër të KM në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse. Projekti mbështet organizimin rregullisht të mbledhjeve të KM për të konfirmuar planet e aktiviteteve, për të vlerësuar progresin e tyre dhe për të dhënë rekomandime bazuar në raportet dhe propozimet nga institucionet përkatëse dhe GP.
- 2) **Kapacitete më të mira të administrimit të parkut.** Projekti përfshin katër objektiva kryesore për zhvillimin e kapaciteteve së bashku me katër grupe pune tematike.

Përmirësimi i monitorimit të biodiversitetit



Me synimin për të shfrytëzuar rezultatet e monitorimit për të përmirësuar ekosistemin, puna do të fokusohet në përmirësimin e biodiversitetit në të gjithë parkun, dhe përmirësimin e kapaciteteve për të monitoruar ekosistemin.

Promovimi i peshkimit të qëndrueshëm

Projekti synon të eliminojë çdo shqetësim në lidhje me sedimentimin në rrugët ujore që lidhin lagunën dhe detin e hapur për të krijuar një mjedis ku burimet e peshkimit mund të përdoren në mënyrë të vazhdueshme. Një studim do të realizohet për të shikuar mundësinë se si të përmirësohet peshkimi dhe mjedisi brenda lagunës.

Promovimi i bujqësisë së qëndrueshme

- 1) Situation Survey and Narrowing Down
- 2) Value Chain and Market Survey
- 3) Planning of Sustainable Agriculture (Short, Mid and Long-term Road Map)
- 4) Preparation of the Short-term Plan based on the Road Map (Work Plan)
- 5) Implementation of the Short-term Plan (Work Plan)
- 6) Organizing the Trainings
- 7) Progress Monitoring and Preparation of the Final Report

Promovimi i Eko-Turizmit



Bashkëpunimi me sektorin e turizmit për të menaxhuar kërkesat nga ky sektor dhe përgatitur AdZM-në për rregullimin e ekuilibrit të duhur në PKDK.

Promovimi i Edukimit Mjedisor

Koncepti i edukimit mjedisor në projekt është të rrisë vlerën e PKDK si një burim arsimor edukativ si dhe duke përmirësuar funksionet e Qendrës së Vizitorëve, e cila gjithashtu do të kontribuojë në eko-turizëm.



Shkëmbimi më i mirë i njohurive dhe përvojave.

Projekti do të shkëmbejë përvojën e menaxhimit të bazuar në ekosistem dhe do të organizoj workshop-e dhe seminare për këtë qëllim.

Mekanizmi mbështetës për të lehtësuar MBE.

"Përmirësimi" korrespondon në tre rezultate: (1) përmirësimin e aktiviteteve të Komitetit të Menaxhimit (KM) dhe GP, (2) ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e planeve të menaxhimit të parkut, dhe (3) ngritjen e kapaciteteve për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave dhe marrëdhënieve me publikun. Prandaj, modeli i menaxhimit të MBE i synuar nga projekti duhet të arrihet me anë të këtyre përmirësimeve të kapaciteteve.

Çdo rezultat është gjithashtu një komponent i modelit MBE dhe, si i tillë, duhet të jetë i lidhur në mënyrë të pavarur me qëllimin e projektit dhe të bashkohet në mënyrë organike. Në këtë cikël, menaxhimi i përshtatshëm i bazuar në ekosistem duhet të përcaktohet dhe përditësohet gjatë gjithë aktiviteteve të projektit nga gjendja reale e PKDK dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit.

1 MBËSHTETJE TEKNIKE SË BASHKU ME GRUPET E PUNËS.

Projekti aplikon modelin e MBE që duhet të bazohet në informacionin shkencor/ të dhënat e marra nga monitorimi i të gjitha aspekteve në parkun kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe ciklin PDCA mbi çështjet e nxjerra dhe, rishikimin e planit të menaxhimit në kohë. Grupet tematike të punës përfshihen në këtë proces praktikisht për të zbatuar masat të caktuara nga KM.



Grumbullimi i të dhënave është baza për të analizuar trendin historik.

2 PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË ADMINISTRATËS DHE SHËRBIMEVE NË PKDK



Mbledhja e personelit të AdZM-së PKDK është pika fillestare për të gjithë etapat në MBE

Administrata e Parkut është institucioni që përqëndrohet në punën për parkun. Ka burime të kufizuara, por duke rritur kapacitetin e saj koordinues, do të mund të merret me të gjitha çështjet e lidhura me Parkun Kombëtar si sekretariat i KM. Administrata e Parkut gjithashtu duket të jetë një bazë e marrëdhënieve publike duke përfshirë turizmin dhe duke bashkëpunuar me industrinë.

3 ZHVILLIMI I STAFIT

Rritja e kapaciteteve të stafit, nëpërmjet trajnimit teknik, është një burim i rëndësishëm që personeli i zyrës së menaxhimit të kuptojë MBE dhe të kontribuojë në përmirësimin e tij përmes ekspertizës dhe aftësive të tyre. Në zyrën e PKDK, ka filluar aplikimi i njohurive dhe shërbimeve teknike. Personeli është i ngarkuar me një temë të veçantë në GP bazuar në kualifikimin e tyre. Për më tepër, projekti ndihmon aplikimin e shërbimeve të reja duke përsëritur ciklin e PDCA.



Trajnim mbi Monitorimin e Biodiversitetit

3 SHKËMBIMI I MUNDËSIVE



Qendra e Vizitorëve është një nga burimet më të rëndësishme për të shkëmbyer përvojat dhe rezultatet e projektit.

Ka shumë mënyra të ndryshme për përmirësimin e MBE. Gjithashtu ka edhe shumë mënyra për promovimin e shkëmbimit të përvojave praktike si brenda ashtu edhe jashtë PKDK. Përveç qëllimit të edukimit, projekti synon gjithashtu të mbledhë eksperiencat të larmishme alternative në parqet e tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Projekti është i gatshëm gjithashtu për shkëmbimin e ideve dhe përvojave me praktikantët që punojnë në MBE.

Fokusi aktual dhe plani për të ardhmen.

Në muajin Maj 2021, projekti filloi nga zbatimi duke prezantuar "Planin e Punës" në Mbledhjen e Parë të Komitetit të Përbashkët Koordinues të Projektit. Projekti tani është duke punuar në formimin e 4 grupeve tematike të punës dhe krijimin e lidhjes midis të gjithë anëtarëve dhe grupeve të interesit në kuadër të Komitetit të Menaxhimit të Parkut si platforma për rregullimin, koordinimin harmonizimin e të gjithëve.

